



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	18.11.2020	26.11.2020
-------------	------------	------------

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.11.2020, OE “Ejona” - Pejë, ka parashtruar ankesë me nr: 954/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Ekotermika”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës Hasan Prishtina”, me nr. të prokurimit: VU644-20-4997-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrrisë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 38,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 15.09.2020, data e hapjes së ofertës: 12.10.2020, data e vendimit për dhënien e kontratës: 21.10.2020, data e njoftimit të me letër standarde: 21.10.2020

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, për të cilin pretendon se i njëjti ka ofruar cmime Jo/Normalisht të uleta dhe njëherit pretendon se AK-ja, me rastin e kërkesës për qasje në dokumentacion zyrtarë, nuk i ka ofruar kopje fizike të cilat i ka kërkuar OE ankues. Poashtu i njëjti pretendon se AK-ja, nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

N/A

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i përgjegjshëm

OE i rekomanduar per kontratë është i përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, eshte njoftuar nga AK-ja, me letren standarde te tenderuesit te pasuksesshem dh njeherit ne ankesen e tij ka pretendime ankimore lidhur me oferten e te rekomanduarit per kontrate.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, pretendon qe i rkeomanduari per kontrate ka ofruar cmim Jo/Normalishte te ulet, me arsyetimin se ne jemi bashkepunetor qe disa vite me prodhuesin "Metron" – Greqi me te cilin ka ofertuar edhe OE i rekomanduar per kontrate, dhe nga i njeiti prodhues kemi marr konfirmimin se eshte e pamundur te behet furnizimi me cmimet te cilat i ka ofruar OE i rekomandaur per kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesen e tij e ka bashkangjitur nje fature te prodhuesit "Metron", me te cilen pretendon se cmimi i dhene nga OE i rekomanduar per kontrate eshte cmim Jo/Normalishte i ulet, te cilen do te ja bashkangjes ketij raporti.

Eksperti shqyrtues lidhur me kete pretendim fillimisht sqaron se vleresimi i cmimit sipas dispozitave te nenit 61 te LPP-se, eshte e drejte e autoritetit kontraktues dhe ne rastin konkret AK-ja, nuk ka verejtur se ka cmime Jo/Normalishte te uleta.

Eksperti shqyrtues sqaron se eshte i paqendrueshem pretendimi i OE ankues, lidhur me mosrespektimin e dispozitave te Rregullores per cmime Jo/Normalishte te uleta, per faktin se ne rastin konkrete, ne kete aktivitet te prokurimit kane ofertuar vetem dy operator ekonomik, prandaj eshte e pamundur te aplikohet formula e dhene ne rregulloren per cmime jo/normalishte te uleta dhe njeherit eksperti shqyrtues, sqaron se nuk mund te merret per baze pretendimi i OE ankues se vlere e ofertes se OE te rekomanduar per kontrate eshte me shume se 25% me e ulet se sa vlere e parashikuar e kontrates.

Pretendimi i OE ankues, se AK-ja, me rastin e pranimit te kerkeses per rishqyrtim nuk e ka pezulluar automatikisht aktivitetin e prokurimit, nuk qendron per faktin se sipas dispozitave te nenit 108/A nuk ka nje afat te caktuar per ta pezulluar dhe ne sistemin e e-prokurimit gjendet vendimi per pezullim te aktivitet te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, ne fund sqaron se OE ankues kerkon qe OE i reomanduar per kontrate te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se i rekomanduari per kontrate ka dhene cmim Jo/Normalishte te ulet dhe njeherit kerkon qe aktiviteti i prokurimit te kthehet ne rivlersim dhe krejt ne fund kerkon qe te anulohet aktiviteti i prokurimit ne fjale me arsyetimin se ka shume shkelje.


Ekspteri shqyrtues, sqaron se kerkesa per anulim te aktivitet te prokurimit, perderisa vet OE ankues eshte i pergjegjshem sipas autoritetit kontraktues, deshmon se OE ankues nuk ka interes material ne kete aktivitet te prokurimit, sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, andaj ekspertit shqyrtues e vlereson si te pa bazuar ankesen e OE ankues.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar, ndersa vendimi i AK-së për dhënie te kontrates te mbetet ne fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|---------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | – KOMUNA VUSHTRRIË. |
| - Panelit Shqyrtues | – OSHP. |
| - OE ankues | - EJONA. |



a= mm
b= mm

General Data

Load/Persons 10 : 750 Kg
Speed: 1 m/s
Travel: 11700 mm
Headroom: 4500 mm
Pit: 1000 mm
Stops: 4

Weight Details

P+Q=1506Kg
Sling Weight+Isolation: 164 Kg
Cabin Weight: 382 Kg
Door Weight: 210 Kg

Machine Room Details

Position: -

Cabin Details

☒ Cabin Width: 1260 mm
Depth: 1380 mm
Type: Tempo
Finishing: Satin
Floor: Tile
Area: 1,74 m²
Internal Height: 2075 mm
External Height: 2330 mm

Shaft Details

Shaft Width (x): 1800 mm
Shaft Depth (y): 1900 mm
Confirmed Shaft Width: ☐
Counterweight Position: Right
Shaft Material: Concrete
Cabin Guide Rails: 75X62X10 5 m
DBG (Distance between Guide Rails): 1330 mm
Distance between Brackets: 2000 mm
Counterweight Guide Rails: 50X50X5
cwdbg (Dist. Between Cw Guide Rails): 800 mm
Distance between Brackets: 2000 mm

Cop Details

☒ COP [1] TP Satin ☐ No smoking ☐ Emergency Light ☒ Speaker
☒ Graphic LCD ☒ Opening [2] ☐ Fan Button ☐ Stop ☒ Intercom with 3 Devices
☒ Button: RDB ☒ Closing [2] ☐ On/Off Switch ☒ Intercom Button ☐
Color: Blue ☒ Alarm ☐ Overweight Call Buttons [5] ☐ Logo

Locking Key: 0 Triangular Switch: 0 Card Reader: 0 Keypad: 0

Door Details

Cabin Doors			Type	Finishing	Opening		mm	Standard	Pcs	Panels (Landing & Cabin)		Pcs		
<input checked="" type="checkbox"/>	A	2-Panel Telescopic Luna C	Satin	900	mm	Standard	1	<input type="checkbox"/>	Photocell		<input type="checkbox"/>	Reinforced sills		
<input checked="" type="checkbox"/>	B	2-Panel Telescopic Luna C	Satin	900	mm	Standard	1	<input checked="" type="checkbox"/>	Photocurtain		<input checked="" type="checkbox"/>	Locking Device		
									<input type="checkbox"/>	Cam		<input checked="" type="checkbox"/>	Toe Guards	
									<input type="checkbox"/>	Electromagnet	48 V			
Landing Doors					FireProof									
<input checked="" type="checkbox"/>	A	2-Panel Telescopic Cronus	Satin	900	mm	-	4							
<input checked="" type="checkbox"/>	B	2-Panel Telescopic Cronus	Satin	900	mm	-	1							
									Doors Clear Height:		2000	mm		